



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201900991/15

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda:** *Rekomandohet sigurimi në mënyrë të plotë i trajtimit shëndetësor për të dënuarin G. K. sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë si dhe plotësimi në mënyrë të lexueshme të dokumenteve të lëshuara nga mjekët gjatë kryerjes së praktikës klinike*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Drejtorit të Përgjithshëm  
Z. Agim Ismaili  
Tiranë

**QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA", TIRANË**

Drejtorit  
Z. Enkelejd Joti  
Tiranë

**IEVP MALËSI E MADHE (REÇ)**

Drejtorit  
Z. Dede Zhivani

**SPITALIT RAJONAL LEZHË**

Drejtorit  
Dr. Leon Kaza

**IEVP LEZHË**

Drejtorit  
Z. Bukurosh Malluta

**Për dijëni:** Shefit të Shërbimit të Nefrologjisë  
Prof.Dr. Myftar Barbullushi

*Të nderuar Zotërinj,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e përfaqësuesit ligjor të të dënuarit G. K. (pacient që i është nënshtruar një operacioni dhe ka bërë transplant veshke), i cili pretendon se gjendja shëndetësore e të dënuarit mund të përkeqësohet për shkak të kushteve të burgut dhe mungesës së medikamenteve.

Referuar shpjegimeve të dhëna në ankesë dhe dokumentacionit që na ka vënë në dispozicion përfaqësuesi ligjor i të dënuarit rezulton se: shtetasi G. K. është dënuar nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda me 4 vjet e 8 muaj burgim për veprën penale “trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, në rolin e ndihmësit. Gjatë kohës që zhvillohej procesi gjyqësor, kohë kur ai ishte me masë sigurimi “garanci pasurore”, G. K. i është nështruar një operacioni në Itali, ku ka bërë transplant veshke të dhuruar nga motra. Kur ai është kthyer në Shqipëri është ndaluar nga Policia e Shtetit për të ekzekutuar vendimin nr. \_\_, datë \_\_\_\_ të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe është dërguar në datën 08.07.2019<sup>1</sup> në I EVP Lezhë për të vuajtur dënimin.

Për të verifikuar ankesën e paraqitur, pra nëse i dënuari ka marrë trajtim shëndetësor sipas rekomandimeve të mjekëve specialistë si dhe nëse kushtet e I EVP Lezhë paraqesin vështirësi për kryerjen e dënimit për të dënuarin G. K. kemi kryer një sërë veprimesh hetimore si:

- administrimi i fotokopjeve të dokumentacionit të siguruar nga përfaqësuesi ligjor dhe të afërmit e të dënuarit G. K.;
- kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve;
- kërkesë për informacion drejtuar Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (Spitali i Burgjeve);
- kërkesë për informacion drejtuar I EVP Lezhë;
- kërkesë për informacion drejtuar Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”;

si dhe janë kryer veprime hetimore në vend, në I EVP Lezhë, në datën 27.09.2019 dhe 25.11.2019 (këqyrje regjistrash, këqyrje e mjedisit të infermierisë, marrja e shpjegimeve nga stafi i burgut si dhe është marrë takim me të dënuarin G. K.).

Gjetjet që do të parashtrijmë më poshtë janë konstatuar deri në datën 25.11.2019, datë kur ka përfunduar hetimi.

Në organikën e stafit shëndetësor të I EVP Lezhë parashikohet të ketë dy mjekë të përgjithshëm, por nga informacioni i marrë në mënyrë shkresore nga Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe I EVP Lezhë si dhe nga verifikimi në vend rezulton se organika ishte e paplotësuar. Një nga mjekët ishte transferuar në I EVP Fushë-Krujë në datën 02.04.2019 ndërsa mjeku tjetër Dr. N. Ç., për arsye shëndetësore, kishte marrë raport të zgjatur mjekësor nga data 30.07.2019 e në vazhdim dhe shërbente me raste në I EVP Lezhë për humanizëm. Këto vende nuk janë plotësuar me mjekë të tjerë për shkak të mungesës së burimeve njerëzore në këtë sektor (nuk afrohen mjekë për t’u punësuar në I EVP). Referuar Regjistrin të hyrje-daljeve në regjimin e brendshëm, Dr.N. Ç., nga data 06.08.2019 deri në datën 25.11.2019, ka hyrë në regjimin e brendshëm të institucionit 10 herë.

I EVP Lezhë, me Urdhërin Nr.5716 Prot., dt. 13.08.2019, në mungesë të mjekëve, ka ngarkuar me detyra shtesë farmacisten Znj. B. P.. Kjo punonjëse duhet të drejtojë sektorin e shërbimit shëndetësor, duke kryer detyra me karakter organizativ, me përjashtim të kompetencave që kanë të bëjnë me specialitetin e karakterit të veçantë të mjekut dhe firmosjes së dokumentave që vetëm ky i fundit mund t’i firmosë. Është e qartë se, farmacistja nuk mund të zëvendësojë mjekun dhe me njohuritë e saj nuk mund të vlerësojë nevojat që kanë të dënuarit me probleme shëndetsore si dhe të interpretojë të dhënat e kartelës klinike. Në letërkëmbimin e mëparshëm që kemi patur me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë jemi vënë në dijeni se: shkaku i identifikuar për mungesën e interesit për të punuar në shërbimin shëndetësor të burgjeve

---

<sup>1</sup> I dënuari G. K. është transferuar në I EVP Malësi e Madhe (Reç) pas tërmetit të datës 26.11.2019.

është vështirësia e punës dhe paga e ulët e personelit mjekësor, më e ulët se e kolegëve që punojnë në spitalet publike. Për këtë arsye është kërkuar rritja e pagave të mjekëve, stomatologëve dhe farmacistëve në sistemin e burgjeve. Ministria e Drejtësisë, me shkresat Nr.2791/3, dt. 30.04.2019 dhe Nr. 5747/1 Prot., dt. 30.08.2019, ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore të fazës së parë dhe të dytë të PBA-së 2020-2022, ku në zërin “kërkesa shtesë për shpenzime korrente”, është kërkuar rritja e kategorisë së pagave të stafit mjekësor në sistemin e burgjeve.

Në raportin mjekësor të dt. 31.05.2019 të lëshuar nga Spitali Niguarda të Milanos (spital në të cilin është realizuar ndërhyrja kirurgjikale, transplantit i veshkës), janë dhënë rekomandime për pacientin G. K., i cili duhet të përdorë disa lloj medikamentesh në një orar të caktuar dhe duhet të kryejë disa analiza/ekzaminime specifike çdo 2-3 muaj dhe një herë në vit. Gjithashtu, Spitali Niguarda i ka vënë në dispozicion pacientit manualin në gjuhën italiane ku përshkruhen rregullat që duhet të respektojnë personat që i janë nënshtruar transplantit të veshkës në jetën e përditëshme (higjiena, aktiviteti fizik, ushqimi etj.). Mjeku specialist italian që ndjek G. K., në informacionin e të datës 12.11.2019 shprehet ndër të tjera se, niveli i tacrolimus duhet të matet 1 herë në muaj për ta mbajtur rreth vlerës 8 ng/ml, në mënyrë që të shmanget flakja e veshkës së transplantuar.

Referuar kartelës klinike, regjistrin të hyrje-daljeve të të burgosurve të I EVP Lezhë, përgjigjes që kemi marrë nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitali i Burgjeve rezulton se: i dënuari G. K. është pranuar në I EVP Lezhë në datë 08.07.2019. Në datë 12.07.2019, i dënuari është dërguar në Spitalin e Burgjeve dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe është kthyer në I EVP Lezhë në 19.07.2019. Gjatë qëndrimit në Spitalin e Burgjeve në këtë hark kohor i dënuari ka kryer konsultë me nefrologun e QSUNT dhe analizat si vijon: gjak komplet, bilanc biokimik, urinë komplet. Në përmbledhjen e daljes nga Spitali i Burgut shkruhet se, rekomandohet mjekim i rregullt ambulator pranë Spitalit Rajonal me qëllim mosflakjen e veshkës dhe të ndiqet nga nefrologu i rrethit. Në një tabelë janë dhënë doza dhe shpeshtësia e barnave që duhet të përdorë i dënuari në vijim, por pa caktuar orarin e marrjes. Në dt. 29.08.2019 G. K. ka shkuar sërish në Spitalin e Burgjeve nga ku është kthyer brenda ditës. Në këtë datë ai ka kryer konsultë me kardiologun, echo abdominale dhe analizat si vijon: gjak komplet dhe bilanc gjaku. Në dt. 04.09.2019 është dërguar në Spitalin Rajonal Lezhë ku ka kryer konsultë me mjekun nefrolog, i cili ka rekomanduar dërgimin e pacientit në QSUNT, për të përcaktuar trajtimin posttransplant në Shqipëri, megjithëse në fletë-daljen e datës 18.07.2019 ishte përcaktuar trajtimi posttransplant me medikamente. Kur G. K. ka qenë i shtruar në Spitalin e Burgut, ai është konsultuar nga mjekët e Kabinetit të Transplantit, të cilët gjithashtu kanë dhënë rekomadim lidhur me medikamentet që ai duhet të përdorë, por nuk është shënuar data e rekomandimit. Medikamentet e rekomanduara nga mjekët italianë, ato të rekomanduara në fletë-daljen nga Spitali i Burgjeve dhe ato të rekomanduara nga mjekët e Kabinetit të Transplantit kanë pak ndryshime, në emërtin, dozë dhe numër. Mjekët shqiptarë kanë vendosur emrin e principit aktiv të medikamentit, ndërsa mjekët italianë, për ndonjë medikament kanë vendosur emrin tregtar të tij. (Bashkëlidhur do të gjeni medikamentet e rekomanduara në të tre rastet.)

Në datën 25.11.2019, datë kur janë kryer veprimet e fundit hetimore për këtë rast, i dënuari G. K. është dërguar në Spitalin e Burgjeve, ku sipas informacionit verbal ka kryer analizat si vijon: urinë komplet, gjak komplet dhe bilanc gjaku. Pra, i dënuari G.K., nga momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor deri në datën 25.11.2019, është dërguar vetëm tre herë në Spitalin e Burgjeve për të kryer analizat e lartpërmendura.

Me shkresën Nr. K2/S30-8 Prot., dt. 22.10.2019, i jemi drejtuar QSU “Nënë Tereza”, ku ndër të tjera kemi kërkuar përgjigje për pyetjet:

*Cilat janë analizat/ekzaminimet që duhet të kryejë ky pacient dhe periodiciteti i tyre? A kryhen këto analiza/ekzaminime në Spitalin Rajonal Lezhë apo në QSUNT?*

*A përdoret në Shqipëri një manual i ngjashëm me atë të Spitalit ku përshkruhen rregullat që duhet të respektojnë personat që i janë nënshtruar transplantit të veshkës në jetën e përditëshme? Nëse po na dërgoni një fotokopje. A janë dhënë rekomandime për pacientin G. K. lidhur me këto rregulla?*

*A është rekomanduar vizitë e pacientit G. K. te dermatologu lidhur me forunkulat e skuqura që i janë shfaqur në sipërfaqe të lëkurës?<sup>2</sup>*

QSUNT na ka dërguar analizat dhe ekzaminimet që duhet të kryejë pacienti duke u shprehur se ato duhet të kryhen patjetër sipas periodicitetit dhe se pjesa më e madhe realizohen në Spitalin e Lezhës, ndërsa pjesa tjetër në QSUNT, me përjashtim të nivelit tacrolimus, i cili realizohet vetëm në laborator privat. Bashkëlidhur na ka dërguar tabelën e analizave dhe ekzaminimeve.

Gjatë qëndrimit në IEVP Lezhë, nga data 08.07.2019 deri në datën 25.11.2019, kur kemi kryer veprimet e fundit hetimore, G. K. ka kryer vetëm analizat dhe ekzaminimet si vijon: gjak komplet(3 herë), bilanc biokimik(3 herë), urinë komplet(2 herë), echo abdominale, konsultë me kardiologun dhe konsultë me nefrologun. Po të bëjmë krahasimin me tabelën e analizave dhe ekzaminimeve që duhet të kryejë pacienti rezulton se ato nuk janë kryer sipas rekomandimeve. Në kartelën klinike të pacientit në IEVP Lezhë nuk gjendet tabela me ekzaminimet dhe analizat që na ka dërguar QSUNT. Në mungesë të një dokumenti që provon se tabela i është dërguar IEVP Lezhë nuk mund të themi nëse ajo është vënë në dispozicion ose jo nga QSUNT. Mungesa e këtyre rekomandimeve në kartelën e pacientit përbën një rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e tij në këtë rast specifik, pasi siç shprehet vetë QSUNT dhe mjeku Italian i Spitalit Niguarda, analizat duhet të kryhen patjetër në mënyrë që të shmanget flakja e veshkës së transplantuar. Ndërsa pyetja e dytë dhe e tretë nuk kanë marrë përgjigje. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që G. K. të jetë dërguar te dermatologu për të kryer vizitën përkatëse sipas rekomandimit dhe në kartelën e tij ndodhet vetëm manuali në gjuhën italiane ku përshkruhen rregullat që duhet të respektojnë personat që i janë nënshtruar transplantit të veshkës në jetën e përditëshme.

Nga këqyrja e *Regjistrit të terapisë mjekësore për infermierët* rezultoi se, janë shënuar sasia dhe emërtimet e medikamenteve të sjella nga familjarët<sup>3</sup>, por nuk janë shënuar medikamentet që IEVP-ja i ka siguruar të dënuarit G. K. E pyetur për këtë fakt farmacistja e IEVP-së na ka informuar se, praktika është që, medikamentet e siguruar nga institucioni dorëzohen në mirëbesim në infermieri dhe bashkohen në një çantë të veçantë me medikamentet që kanë sjellë familjarët, por nuk shënohet në regjistrë sasia dhe lloji i tyre. Në kartelën Klinike të të dënuarit u gjet vetëm një recetë për tre medikamente që kishte siguruar IEVP-ja për të dënuarin G. K., me kohëzgjatje 30 ditë. Receta mban datën 26.09.2019. E pyetur se përse nuk janë siguruar të gjitha medikamentet

<sup>2</sup> Në shkresën nr.3926/1 Prot., dt. 15.07.2019, ku mjeku i IEVP Lezhë Dr. N. Ç. i kthen përgjigje përfaqësuesit ligjor të të dënuarit, përmend forunkulat e skuqura të konstatuara në trupin e G. K. Në raportin mjekësor të dt. 31.05.2019 të lëshuar nga Spitali Niguarda të Milanos thuhet se është programuar një vizitë te dermatologu në Muajin Qershor lidhur me njollat në toraks.

<sup>3</sup> Familjarët kanë sjellë medikamente në datat 20.09.2019, 28.10.2019 dhe 15.11.2019.

e rekomanduara nga mjekët shqipëtarë dhe nëse janë siguruar medikamente për muajin Nëntor 2019, farmacistja na informoi se i dënuari ka dashur të përdorë medikamentet që i ka sjellë familja nga Italia dhe se receta për muajin Nëntor ndodhej në farmacinë e Spitalit Rajonal të Lezhës. Kërkesa e të dënuarit për të mos përdorur të gjitha medikamentet e siguruar nga shteti shqiptar ishte pranuar pa u mbajtur ndonjë procesverbal. Edhe në përgjigjen që na ka kthyer IEVP Lezhë me shkresën Nr.6216/1 Prot., dt. 22.11.2019 thuhet se: *“Preparatet e tjera antihypertensive ia ka siguruar familja pasi i ka dashur më cilësore siç janë preparatet e rimbursueshme që ka vetë institucioni”*.

Sa i përket ankesës në lidhje me vështirësitë e kushteve të vuajtjes së dënimit, është konstatuar se mjedisi i infermierisë ku mbahet i dënuari G. K., veçanërisht tualeti i përbashkët, nuk i plotëson kushtet higjieno-sanitare skrupuloze që rekomandohet për pacientët e transplantuar në manualin e Spitalit Niguarda të Italisë. Mjedisi është i amortizuar dhe me lagështirë. Në infermieri ndodhen tre dhoma për qëndrimin e të burgosurve me probleme shëndetësore. I dënuari G. K. është i akomoduar në një dhomë me tre persona të tjerë, të cilët gjithashtu kanë probleme shëndetësore. Kontakti i afërt me këta persona, për një kohë të gjatë, në një mjedis të mbyllur përbën rrezik të shtuar për këtë të dënuar që përdor medikamente për uljen e imunitetit në mënyrë që të mos flakët veshka e dhuruar. Lidhur me rregullat që duhet të respektohen nga i dënuari shprehet edhe mjeku i IEVP Lezhë Dr. N. Ç. në shkresën Nr.6216/1 Prot., dt. 22.11.2019, cituar si vijon:

*“Janë dhënë rekomandime lidhur me rregullat që duhet të respektojë i dënuari në jetën e përditëshme siç janë (higjiena, aktiviteti fizik dhe ushqimi po zbatimi i këtyre rekomandimeve në kushtet e institucionit tonë është tejet e vështirë) pasi disa të dënuar janë me banjo kolektive dhe ajo paraqet vështirësi, në këto kushte rritet probabiliteti i një infeksioni sekondar, i cili do ta rëndonte së tepërmi gjendjen shëndetësore të pacientit duke ulur imunitetin e tij dhe duke shtuar rrezikun e flakjes së organit transplantuar”*.

Si për këtë rast ashtu edhe për ankesa të tjera të të burgosurve që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre shëndetësor, na është dashur të këqyrim kartelat klinike për të verifikuar pretendimet. Në të gjitha rastet kemi hasur në vështirësinë për të kuptuar shënimet e lëna nga mjekët, mjekë të IEVP-ve dhe mjekë të spitaleve. Ndhimëskomisioneri i ngarkuar me hetimin e ankesës ka kërkuar nga mjeku apo infermieri i IEVP-së që të lexojë shënimet dhe në mirëbesim ka raportuar informacionin që i është thënë. Në ndonjë rast vetë mjeku që i ka lënë shënimet ka patur vështirësi për t'i lexuar ato, veçanërisht kur ka kaluar kohë e gjatë nga dita e shkrimit. Edhe në kartelën klinike të të dënuarit G. K. kemi ndeshur me të njëjtin problem. Dokumentat e kartelës klinike nuk janë eskuzivitet i mjekut që i përpilon ato. Shënimet duhet të jenë të lexueshme nga çdo mjek, staf shëndetësor, autoritet që ka kompetencë të njihet me të dhënat e pacientit, familjarët si dhe vetë pacienti. Në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, në zbatim të nenit 4/2/b dhe nenit 20 të Ligjit Nr.123/2014 *“Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohen rregulla lidhur me shënimet që lihen në kartelën klinike.

Në nenin 34 dhe 35 të Kodit parashikohet si më poshtë:

**“Neni 34**

#### ***Dokumentimi i veprimeve mjekësore***

*Të gjitha veprimet diagnostikuese e mjekuese që kryen në praktikën klinike në çdo lloj shërbimi dhe profili ambulator, spitalor, publik a privat, mjeku i përshkruan (regjistron)*

*në dokumentat mjekësore të posaçme, të cilat ruhen e mirëmbahen në përputhje me dispozitat që aplikon institucioni shëndetësor në kushtet e respektimit dhe të ruajtjes së sekretit profesional.*

*Mjeku e ka për detyrë të krijojë Dosjen (kartelën) klinike individuale të të sëmurit, e cila plotësohet dhe ruhet nën përgjegjësinë e mjekut kurues si një dokument i rëndësishëm klinik, studimor-shkencor dhe juridik (mjeko-ligjor). Ai e ka për detyrë të përshkruajë në kartelën klinike qartë e kuptueshëm diagnozat, ekzaminimet dhe interpretimet e tyre, mjekimet dhe argumentat për çdo ndryshim që bën, si dhe konsultat mjekësore që kryhen për të sëmurin e tij.*

### **Neni 35 – Lëshimi i dokumentave mjekësore**

*Në praktikën mjekësore është e domosdoshme bërja e dokumentave mjekësore, çertifikata, epikriza, dëshmi, etj dhe lëshimi i tyre me kërkesë të të sëmurit, familjarëve ose organeve kompetente të njohura me ligj.*

*Çdo dokument që plotëson dhe lëshon mjeku duhet të hartohet në mënyrë korrekte, plotësisht në përputhje me konstatimet mjekësore, të jetë i lexueshëm, ku të mund të identifikohet nënshkruesi dhe firma e tij”.*

Vetë shtetasi G. K., gjatë takimit që ka patur në I EVP Lezhë me ndihmëskomisionerin që ka ndjekur rastin është shprehur se, është i pafajshëm, se ka punuar më parë si saldator për të siguruar mbijetesën e familjes dhe se fati e desh që të saldonte tavanin e një makine të përdorur nga persona për trafikimin e drogës, por nuk kishte lidhje me këtë veprimtari. Për sa i përket trajtimit shëndetësor, G. K. u shpreh se nuk kishte ankesa për stafin e burgut që tregojë i gatshëm për ta ndihmuar, por nuk besonte në cilësinë shërbimit shëndetësor që ofrojnë institucionet shqiptare, shërbim që e ka provuar më parë dhe nuk krahasohet me shërbimin që merrte në Itali. Në Itali atij i është njohur statusi i invalidit duke ju caktuar një pension<sup>4</sup> si dhe të gjitha shpenzimet e vizitave dhe medikamenteve, që kanë kosto të lartë, mbulohen nga shteti italian. Medikamentet që ai përdor nuk janë në shitje dhe në Itali mund t’i marrë vetëm duke u paraqitur personalisht. Ai është baba i tre fëmijëve (një djalë 13 vjeç, një vajze 11 vjeç dhe një djalë 5 vjeç). Bashkëshortja është e papunë<sup>5</sup> dhe siguron mbijetesën me pensionin e nënës dhe ndonjë ndihmë financiare që i dërgon motra nga Italia. Për këtë arsye familja ka vështirësi ta takojë në burg dhe t’i sjellë ushqimin sipas dietës të rekomanduar nga mjekët. Medikamentet e rekomanduara nga mjekët italianë që ai duhet t’i përdorë gjatë gjithë jetës, në dozën dhe orarin e caktuar i ulin imunitetin dhe për këtë arsye ai duhet të ruajë higjenë të përsosur. Por, në kushtet e burgut kjo gjë nuk është e mundur.

Në fund të këtij hetimi administrativ, mendojmë se shqetësimet e ankuesit sa i përket vështirësive në ofrimin e shërbimit shëndetësor si dhe kushteve higjeno-sanitare të ambienteve ku i dënuari Gëzim Kurti vuan dënimin, qëndrojnë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien

<sup>4</sup> Të afërm të të dënuarit na kanë vënë në dispozicion fotokopje të librezës së invaliditetit dhe pensionit të caktuar nga shteti Italian.

<sup>5</sup> Të afërm të të dënuarit na kanë vënë në dispozicion vërtetimin se Znj. F. K. është regjistruar si punëkërkuese e papunë në zyrën e punësimit Lezhë.

*në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e organikës së IEVP Lezhë me mjekë për t'u garantuar të dënuarve dhe të paraburgosurve ofrimin e shërbimit shëndetësor në këtë institucion (rekomandim për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve);
- Të vihet në dijeni IEVP Malësi e Madhe ku ndodhet i dënuari G. K. lidhur me ekzaminimet/analizat që ai duhet të kryejë, oraret kur duhet të marrë çdo medikament si dhe me rregullat që duhet të respektojnë personat, të cilët i janë nënshtruar transplantit të veshkës në jetën e përditëshme në gjuhën shqipe (rekomandim për Kabinetin e Transplantit në QSUNT);
- Kryerjen e ekzaminimeve/analizave të rekomanduara nga mjekët specialistë sipas periodicitetit të përcaktuar për të dënuarin G. K. (rekomandim për IEVP Malësi e Madhe dhe Spitalin Rajonal Lezhë);
- Plotësimin në mënyrë të lexueshme të dokumenteve të lëshuara nga mjekët gjatë kryerjes së praktikës klinike në çdo lloj shërbimi dhe profili ambulator apo spitalor (rekomandim për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, QSUNT dhe Spitalin Rajonal Lezhë);
- Përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare në mjedisin e infermierisë në IEVP Lezhë (rekomandim për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Lezhë);
- Lënien e shënimeve në regjistrin e vizitave mjekësore dhe në kartelën mjekësore të sasisë dhe llojit të barnave që dorëzohen në infermieri, si të barnave mjekësore të siguruara me shpenzimet e të dënuarve apo të paraburgosurve ashtu edhe të atyre që siguron IEVP-ja (rekomandim për IEVP Lezhë);
- T'i vihet në dispozicion të dënuarit rekomandimi i mjekut specialist lidhur me trajtimin e tij me barna mjekësore dhe në rast se ai nuk pranon të marrë barnat që i siguron IEVP-ja, por ato që i siguron familja të mbahet procesverbali përkatës (rekomandim për IEVP Lezhë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve).

Bashkëlidhur rekomandimit do të gjeni fotokopje të dokumentave si më poshtë:

- Raportin mjekësor të dt. 31.05.2019 të lëshuar nga Spitali Niguarda të Milanos, italisht dhe shqip;
- Rekomandime të mjekut italian që ndjek G. K. të dërguara në datën 12.11.2019;
- Manualin në gjuhën italiane të Spitalit Niguarda ku përshkruhen rregullat që duhet të respektojnë personat, të cilët i janë nënshtruar transplantit të veshkës në jetën e përditëshme;
- Fletë-daljen e datës 18.07.2019 ku janë dhënë rekomandime për trajtimin me medikamente për pacientin G. K.;
- Rekomandi i mjekut të IEVP Lezhë dhe mjekut të Spitalit Rajonal Lezhë;
- Terapia me medikamente e rekomanduar nga Shërbimi i Nefrologjisë, Kabineti i Transplantit në QSUNT;
- Tabela me analizat dhe ekzaminimet që duhet të kryejë G. K., që na është dërguar në QSUNT;

- Tabela krahasuese e terapisë me medikamente të rekomanduara nga mjekët italianë, mjeku nefrolog i QSUNT dhe Kabineti i Transplantit në QSUNT;
- Librezës së invaliditetit dhe pensionit të caktuar nga shteti Italian për shtetasin G. K.;

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**